



HISTORI SUKSESI/ ANGAZHIMI I ALUMNIT ADMIR MALAJ PËR ADERIMIN NË "FARMAKOPE"

Katër vite aktivizim për sigurinë farmaceutike

ASP

Angazhimi i alumnit të Shkollës së Studimeve Politike për ratifikimin e konventës evropiane Farmakope

Katër vite advokim për siguri farmaceutike

Që prej muajit shtator 2019 Shqipëria u bë pjesë e vendeve që aderojnë në konventën evropiane të Farmakopesë, një mekanizëm i Këshillit të Evropës që përcakton standartet e cilësisë dhe kontrollit për sektorin farmaceutik. Ratifikimi nga Parlamenti i dha fund një neglizhence institucionale 24 vjeçare, që e kishte mbajtur Shqipërinë si të vetmin vend në hapësirën evropiane jashtë konventës. Pakkush mund të ndjehet sot më i gëzuar nga ky vendim sesa Admir Malaj, farmacisti alumn i Shkollës së Studimeve Politike, i cili nisi katër vite më parë një aktivizim të mirëfilltë advokues për këtë çështje.



Insistimi i tij i palodhur në çdo takim me diplomatët e huaj, angazhimi i studentëve të farmacisë, por dhe mediatizimi i kësaj problematike, mund të thuhet tashmë se

ia kanë vlejtur. Kjo është padyshim njëra nga historitë e suksesit të kontributit që ofrojnë alumnët e Shkollës në proceset e politikëbërjes dhe nxitjen e reformave të rëndësishme integruese në vend.

Rrjetëzimi në Këshillin e Evropës

Si një profesionist dhe kërkues shkencor në fushën rregullatore farmaceutike, Admir Malaj u bë pjesë e Shkollës së Studimeve Politike të gjeneratës 2015. Falë programit të Shkollës, atij iu dha mundësia që të vizitonte Këshillin e Evropës dhe misionin diplomatik shqiptar në Strazburg, aty ku ndodhet edhe selia

Farmakope e shpjeguar në pak rreshta

Farmakopeja, në kuptimin e ngushtë të fjalës, është një botim që përmbledh përshkrimet e substancave dhe preparateve mjekësore në tërësi, të metodave për përgatitjen dhe kontrollin e pastërtisë dhe vlefshmërisë së tyre, si dhe informacione të tjera me rëndësi. Farmakopeja botohet nga një autoritet i njohur zyrtarisht dhe shërben si standard për sektorin farmaceutik.

Gjatë kohës çdo vend kishte hartuar farmakope më vete, në mënyrë autonome, duke krijuar mospërputhje ndërmjet standardeve të



preparateve mjekësore, nga njëri vend tek tjetri. Kjo gjë do ndikonte natyrshëm dhe në nivelin e shëndetit të popullsisë së tyre. Pikërisht mbi këtë problematikë ngrihet dhe nisja e Këshillit të Evropës për

të miratuar një konventë, e cila do të synonte përpunimin e një Farmakopeje Evropiane unike, e cila mund të garantonte standarde të njëjta për preparatet mjekësore në të gjithë hapësirën Evropiane,

konventë që së fundmi u ratifikua dhe nga vendi ynë. Konventa është dhe pjesë e acquis communautaire dhe plotësimi i kriterëve të Farmakopesë Evropiane është deyrim ligjor për autorizimin e tregtimit në Bashkimin Evropian.

Këshilli i Evropës me këtë nisëm njohu rëndësinë që ka harmonizimi i specifikimeve të preparateve mjekësore për popujt e Evropës, në lidhje me prodhimin, qarkullimin dhe shpërndarjen e tyre, në kuadër të progresit në fushën e shëndetit publik dhe social për vendet anëtare.



Admir Malaj, alumni i gjeneratës 2015

e Farmakopesë. Në pritjen e shtruar nga ambasadorja Ardiana Hobdari, Admiri pati mundësinë që të diskutonte mbi problematikën e sigurisë farmaceutike, si dhe për Farmakopenë evropiane. Vendi ynë gëzonte statusin e vëzhguesit në këtë organizëm, por nuk kishte përfaqësim të rregullt në aktivitetet e tij. Ambasadorja shprehu interesimin e vazhdueshëm të misionit për anëtarësimin në Farmakope si dhe ftesat e dërguara institucioneve përgjegjëse për të pasur një përfshirje më të madhe.

Në vazhdim të këtij takimi, Admiri mundësoi vendosjen në kontakt të ambasadores me drejtoreshën e Agjencisë Kombëtare të Barnave. Si pasojë e këtij rrjetëzimi një delegacion nga Shqipëria u ftua në mbledhjen e rradhës të Farmakopesë, një përfaqësim i munguar prej shumë vitesh nga institucionet shqiptare. Gjatë vitit 2016 dhe më vonë, vizitat e del-

egatëve shqiptarë në takimet e Farmakopesë u shpeshuan por për fat të keq, ky komunikim nuk u shoqërua me një rezultat pozitiv. Për shkak të disa ndryshime në pushtetin ekzekutiv që prekën edhe institucionet përgjegjëse për politikën në Shëndetësi si dhe mbarimin e misionit të zonjës Hobdari në Strazburg, u duk se heshtja do të mbulonte përsëri këtë inisitivë. "Në këto momente e kuptova se nuk mjaftonte vetëm sensibilizimi dhe vendosja në kontakte e aktorëve për të arritur një hap të tillë. Ishte i nevojshëm një angazhim më i strukturuar advokimi ndaj institucioneve publike", kujton Admiri.

Advokim në politikëbërje

Si një alumni i Shkollës, Admiri u përzgjedh në vitin 2016 për t'u bërë pjesë e një trajnimit mbi advokimin dhe nismat publike, i mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA).

Ndërmjet të tjerash, ai pati mundësi të informohet nga stafi i shkollës dhe trajnuesja znj. Sashenka Lleshaj, mbi mënyrën më të mirë për të çuar përpara një nismë ligjore, sepse anëtarësimi në Farmakopenë Evropiane kërkonte miratimin e ligjit të posaçëm për ratifikimin të konventës në Parlament. "Njohuritë e fituara në këtë trajnim më ndihmuan që të ndërtoj një strategji advokimi ndaj politikëbërësve. Përfshirja e aktorëve të ndryshëm në këtë proces ishte çelësi për të arritur rezultate", nënvizon Admiri. Kësaj radhe ai e filloi ndërhyrjen e tij nga bota akademike.

Admiri ndërmori takime sensibilizuese me kolegë kërkues e pedagogë në fushat farmaceutike dhe me studentët e departamentit të farmacisë. Në fund të vitit 2017, së bashku me këta të fundit, ai filloi një fushatë sensibilizimi në rrjetet sociale me hashtag #DuamFarmakopeSiGjithëEv-

Vlerësimi nga ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Manastirliu: Angazhimi i Admirit dhe studentëve, një rol pozitiv nxitës



Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu

“Aderimi me të drejta të plota në Farmakopenë Evropiane ishte një nga prioritetet e Ministrisë së Shëndetësisë, në përmbushje të detyrimeve që vendi ynë ka në rrugën e anëtarësimit në familjen evropiane. Njëkohësisht, zbatimi i standardeve të Farmakopesë Evropiane do të garantojë vendosjen në vendin tonë të protokolleve evropiane për sigurimin e cilësisë për barnat që prodhohen dhe qarkullojnë në Shqipëri, një nga objektivat kryesore në fokus të ministrisë.

Ky proces, ka kërkuar jo vetëm angazhimin e plotë të strukturave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,

por edhe një bashkërendim të punës me Këshillin e Evropës, si organizata pranë së cilës është ngritur Farmakopeja Evropiane. Sigurisht që edhe vëmendja dhe interesi i shfaqur nga Admiri dhe studentët e farmacisë, kanë patur një rol pozitiv nxitës për të vazhduar këtë rrugëtim, i cili do të kërkojë edhe më shumë angazhim në të ardhmen. Angazhimi i grupeve të interesit në vendimmarrje është jo vetëm i mirëpritur, por edhe i shumëkërkuar nga institucionet tona, për të përmirësuar shërbimet ndaj qytetarëve në sektorin shëndetësor”.

ropa, si dhe disa shënime shoqëruese, që shërbyen për informimin e disa mediave online dhe ato vizive. Kjo ndihmoi që Farmakope të bëhej e njohur për herë të parë nga publiku i gjerë.

Në Prill 2018 Admiri do të tërhiqte vëmendjen e diplomatëve të Delegacionit të Bashkimit Evropian me diskutimin e tij gjatë dëgjësive të shoqërisë civile në vijim të publikimit të raportit vjetor të Komisionit Evropian. Ai do të nënvizonte edhe njëherë përfundimin e raportit mbi “mos qënien në linjë me acquis të legjislacioni mbi barnat”, që të kujtonte edhe njëherë se Shqipëria nuk ishte ende pjesë e Farmakopesë.

Advokimi u intensifikua më tej, kur në maj 2018, u angazhuan në këtë fushatë edhe një grup studentësh të departamentit të farmacisë pranë Universitetit të Tiranës. Të rinjtë dërguan një kërkesë zyrtare informacioni pranë institucioneve përgjegjëse mbi ecurinë e ratifikimit të konventës. Admiri nuk ishte më i vetëm në këtë rrugëtim falë insistimit të palodhur disavjeçar. Në përgjigjen ndaj letrës së studentëve nga Avokati i Popullit, konfirmohet për herë të parë se Ministria e Shëndetësisë kishte iniciuar procesin për ratifikimin e konventës, në bashkëpunim me Ministrinë e Jashtme. Pas 24 vitesh neglizhence, më në fund procesi i anëtarësimit në Farmakope po bëhej realitet.

Ministria e Shëndetësisë finalizoi me sukses procesin ligjor dhe falë tij në shtator 2019, Shqipëria u bë vendi i 39 që aderën në Konventën për Përpunimin e Farmakopesë Evropiane. Ky anëtarësimin krijon mundësitë për standarde cilësie dhe sigurie të barnave, duke na afruar gjithnjë e më shumë me tregun e përbashkët Evropian. Miratimi i saj gjithashtu krijon më shumë mundësi rritjeje profesionale për farmacistët shqiptarë dhe gjithë sektorin farmaceutik të vendit.

“Kur shoh sot pas në kohë, ndjej një

Dëshmia e Ardiana Hobdarit, diplomates pranë Këshillit të Evropës në 2014-2017

Ambasadorja: Bashkëpunimi falë vizitës së Shkollës në Strazburg

"Jam e lumtur të dëshmoj këtë histori suksesi të bashkëpunimit/rrjetëzimit mes shoqërisë civile dhe organeve shtetërore. Gjatë shërbimit tim si Ambasadore/Përfaqësuese e Përhershme e Shqipërisë në Këshillin e Europës, u përpoqa të nxis anëtarësimin e plotë të vendit tonë në Farmakopenë Evropiane (EDMQ). Në përpjekjet e mia, vura re se vetëm komunikimi me organet përgjegjëse shtetërore, përmes rrugës burokratike (Mision-MPJ-Ministri e Shëndetësisë) nuk mjaftonte. Në këtë kuadër, kontakti me Admirin gjatë vizitës së pjesëtarëve të Shkollës së Studimeve Politike në Strazburg, me

rastin e Forumit Botëror për Demokraci, bëri të mundur që të angazhohen aktorë të tjerë, të cilët përmes avokatisë së tyre arritën që kjo përpjekje të materializohet.

Falenderoj njëkohësisht Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Znj. Ogerta Manastirliu, për angazhimin e saj maksimal në kurorëzimin e këtyre përpjekjeve.

Jam e bindur se kjo histori suksesi do të shërbejë si frymëzim për të gjithë pjesëmarrësit e Shkollës për të kontribuar me angazhimin e tyre në përmirësimin e politikave dhe vendim-marrjes".



Ambasadorja Hobdari



Profesori dhe studentët e departamentit të Farmacisë që u përfshinë në fushatën #DuamFarmakopeSiGjithëEvropa: Prof. Ledjan Malaj, Bora Shkurta, Dorjana Cengu, Edon Zairi, Emilia-no Shqefni, Era Gjika, Granit Zhubi, Maria Gabeta, Kristina Margo, Oltiana Canaj, Orion Juca, Sibora Rexha

kënaqësi shumë të madhe për faktin se së bashku me kolegë dhe studentë të

farmacisë kemi qenë të aftë të vendosim dhe mbajmë fort në agjendën e poli-

tikëbërësve ratifikimin e konventës për përpunimin e Farmakopesë Evropiane", shprehet Admiri, në përmbylljen me sukses të një advokimi që ka zgjatur mbi katër vite. Admiri dëshiron të mos mbajë për vete të gjitha meritat e kësaj iniciative: "Nuk do t'ia kisha dalë mbanë pa mbështetjen e shumë aktorëve që u përfshinë në këtë aventurë të gjatë. Shkolla e Studimeve Politike, ka qenë mbështetëseja e nismës falë edukimit mbi advokimin dhe nismat publike, por dhe rrjetëzimit me aktorë të tjerë, që mund të çonin edhe më përpara këtë proces. Një meritë e veçantë i takon Ministrisë së Shëndetësisë që është nismëtare dhe finalizuese e ratifikimit të konventës. Kjo mendoj është sinergjia e duhur midis politikëbërjes, shoqërisë civile dhe akademisë, që i duhet vendit për të bërë në një brez atë që mund të bëhet në dy apo tre breza".

Alumnët që përfaqësuan Shkollën në aktivitetet ndërkombëtare të Këshillit të Evropës

Përgjigje ndaj rreziqeve të demokracisë në Evropë

Rrjeti i Shkollave të Këshillit të Evropës organizoi edhe këtë vit një seri aktivitete me pjesëmarrjen e alumnëve me fokus mbi temat kryesore që ndikojnë në nivelin e demokracisë në Evropë dhe më gjerë. Falë këtyre aktivitete, alumnët mund të ulen së bashku për të analizuar shkaqet e këtyre problemeve të reja dhe gjetjen e rrugëdaljeve të mundshme. Ekspertë të nivelit të lartë janë gjithashtu të ftuar në këto forume për të kontribuar me eksperiencat e tyre.

prezantimet e personalitete të shquara ndërkombëtare me njohuri të thelluara për këto çështje. Alumni Rezar Balla, me eksperiencë në fushën e medias dhe komunikimit, u përzgjedh për të përfaqësuar Shkollën tonë në këtë event.



"Samiti i Ballkanit Perëndimor" (Poznan, 1-6 korrik 2019)



Programi "Akademia e Ballkanit Perëndimor" (Sofje, 2-6 korrik 2019)

Alumnët e Shkollave të rajonit morën pjesë nga 2 deri më 6 korrik 2019 në Akademinë e Ballkanit Perëndimor, të zbatuar nga Shkolla Politike Bullgare. Ujvara Ponari, Edlira Osmani, Besart Mataj dhe Rezart Balla u përzgjedhën për të përfaqësuar shkollën tonë në këtë program. Përmes diskutimeve dhe vizitave studimore, pjesëmarrësit ndanë përvojat e procesit të integrimit evropian në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Kosovë, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Serbi.

Edicioni i katërt i "Tryezave Qytetare" - (Kiev, 7-8 Tetor 2019)

Takimi i këtij viti i "Tryezave Qytetare" kishte si temë kryesore raportin mes demokracisë dhe informacionit. Ky forum që mbledh së bashku rreth 30 alumnë të shkollave dhe të rinj të tjerë evropianë, krijoi një mundësi për të diskutuar efektet e zhvillimeve në teknologjinë dhe mjedisin e mediave mbi sasinë dhe cilësinë e informacionit publik, në çfarë mase kjo mund të ndihmojë ose të pengojë pjesëmarrjen e njerëzve në proceset demokratike dhe efektet e epokës së informacionit në përgjithësi. Diskutimet u lehtësuan nga

Falë bashkëpunimit me Shkollën e Politikës së Vishegradit, APS u përfaqësua në Samitin e Ballkanit Perëndimor të mbajtur në Poznan të Polonisë nga 1-6 korrik 2019. Alumna Edlira Gjoni ishte pjesë e Workshopit anësor me fokus kërkuesit dhe përfaqësuesit e medias, të organizuar gjatë Samitit, që mbledhi kryeministrat e vendeve të përfshira në procesin e Berlinit si dhe drejtuesit e rajonit. Diskutimet u përqëndruan në arritjet aktuale dhe objektivat e ardhshme të Procesit të Berlinit për vendet e rajonit tonë.



Alumnët, një rrjet vlerash

VITI 2007

EMRI	POZICIONI *
Z. Alban Tartari	Zëvendëskryeredaktor i Televizionit Publik Shqiptar, TVSH
Z. Albert Faruku	Deputet
Z. Alfred Gega	Deputet
Z. Andi Krraqi	Kreu i Forumit Rinor të Partisë Demokratiane
Z. Arben Haveri	Drejtor i NBG Bank në Shkodër
Z. Arben Lagreta	Gazetar
Z. Arben Porocani	Ass. Lektor pranë Universitetit të Tiranës
Z. Arben Shkodra	Drejtor i Administratës dhe Shërbimeve, Këshilli i Ministrave
Znj. Arbëresha Mushani	Mësues
Znj. Ardiana Kasa	Menaxhere Programi, organizata "Eorld Vision"

Z. Artemon Cukalla	Kreu i Forumit Rinor të Partisë Aleanca Demokratike
Z. Artur Hasanbelliu	Deputet
Z. Artur Kopani	Drejtor i Televizionit Publik Shqiptar, TVSH
Znj. Blerina Balilaj	Specialiste pranë Institutit Demokratik Kombëtar - NDI
Znj. Blerina Tepelena	Kreu i sektorit të monitorimit të strategjisë për komunitetin Rom
Znj. Elga Mitre	Specialiste pranë ambasadës holandeze në Tiranë
Znj. Elma Tershana (Shehu)	Drejtoresh e Programit për mbikëqyrjen e të drejtave të fëmijëve (UNICEF)
Z. Elton Halimi	Pedagog në Fakultetin e Shkencave, Universiteti i Tiranës

Z. Endri Jorgoni	Këshilltar, Ministria e Transportit, Punëve Publike dhe Telekomunikacionit
Z. Erjon Meta	Analist pranë misionit policor ICITAP
Znj. Ersejla Murati	Gazetare, "Koha" TV
Z. Gramos Qendro	Specialist në Ministria e Transportit, Punëve Publike dhe Telekomunikacionit
Znj. Iva Hyseni	Juriste, Drejtorja e Studimeve, Publikimeve dhe Informacionit në Gjykatën e Lartë
Znj. Kimete Klenja	Koordinatorë programesh pranë organizatës UNIFEM
Z. Kostandin Kazanxhi	Jurist
Z. Ledion Kola	Asistent shërbimi ndaj klientit (ABA)
Znj. Lindita Luzo	Koordinator Projekti në PNUD



Znj. Sidita Gipali Konsulente lokale për Ministrinë e Shëndetësisë

Z. Teki Kurti Kryetari i Këshillit të Komunës Martanesh

VITI 2008

Znj. Arbana Dibra Drejtore ekzekutive e zyrës së OSBE-së në Shkodër

Z. Arben Vata Kryeredaktor, "Ora Neës" TV

Znj. Beslinda Rrugja Asistent avokate

Z. Bledar Kurti Lektor pranë Universitetit të Tiranës

Znj. Brasena Koka Koordinatore projekti pranë organizatës "Eorl Vision"

Znj. Brunilda Minaroli (Peci) Specialist në departamentin për marrëdhëniet ndërkombëtare, Ministria e Jashtme

Znj. Edlira Gjoni Koordinatore projektit EU-CARDS VET të inçinim / Gazetare

Znj. Edlira Mali Drejtor Ekzekutiv e degës së kompanisë "Ogilvy" në Tiranë

Znj. Edlira Papavan-gjeli Koordinatore Programi pranë organizatës Komiteti i Helsinkit

Znj. Elda Zotaj Asistente Administrative në Universitetin e Tiranës

Z. Elson Thana Oficer i Policisë Gjyqësore

Znj. Elvana Zhezha Shef i Kabinetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme

Znj. Eralda Cani Methasani Lektore në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Z. Erion Avllazagai Lektor në Universitetin e Elbasanit

Z. Erjon Tase Analist Politik në "Gazeta Shqiptare"

Z. Erlis Cela Gazetar në gazetën "Standard"

Z. ERVIN KARA-MUCO Zëvendëskomisioner pranë "Avokatit të Popullit"



Znj. EVIS FICO Shef i Sektorit për Emigrimin në Shërbimin Kombëtar të Punësimit

Z. FLIR MOSHO Drejtor i Menaxhimit të Investimeve Publike në Ministrinë e Financave

Znj. GENTIANA RAMADANI Drejtore ekzekutive e organizatës "Gratë për gratë"

Z. GJERGJI TANE Drejtor i Zyrës lokale të punësimit në Korçë

Z. GJOK VUKSANI Deputet

Znj. IVIS NOCKA Shef në Sektorin e Monitorimit, Ministria e Mbrojtjes

Z. KLODIAN RJEPAJ Koordinator Kombëtar në Institutin e Shëndetit Publik

Znj. KLODIANA GJINAJ Këshilltare për mediat pranë KESH

Z. MARIN MEMA Gazetar "Top Channel"

Znj. MONIKA STAFI Gazetare "Top Channel"

Znj. NAHLEL BEJLERI - FICO Inspektore në Shërbimin Social Shtetëror

Z. OLSI KARAPICI Drejtor i Departamentit të IT në Këshillin e Ministrave

Z. REMZI ALIAJ Drejtor rajonal i Shërbimit Social Shtetëror

Z. REZART LAHI Drejtori i Përgjithshëm i "Shijak TV"

Znj. SANIJE FATKOJA HAXHIHYSENI Menaxhere dege e "Opportunity Albania"

Znj. VILMA PREMTI Drejtore në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

VITI 2009

Z. Adrian SHEGA Asistent avokat, Shërbimi ligjor falas Tiranë

Znj. Admira Poci Specialiste pranë Institutit Goethe

Znj. Albana HANA Specialiste në Ministrinë e Integritetit

Znj. Ana XHEKA Drejtore në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Znj. Ardita SHEHAJ Shef departamenti, Autoriteti i Konkurrencës

Znj. Beti NJUMA Gazetare, "Top Channel"

Z. Blerim KOLA Kryeredaktor, Nesër TV

Z. Edvin SHVARC Drejtor i Informacionit Publik dhe Protokolli pranë Presidentit të Republikës

Znj. Elira CANGA Gazetare, "Gazeta Shqiptare"

Znj. Elsa TOSKA (DOBJANI) Këshilltare Ligjore në Gjykatën Kushtetuese

Znj. Entela HAMITI Anëtare e Partisë Socialiste

Znj. Erinda SHAH Anëtare e Partisë G99



Z.	Ermal GJINAJ	Kreu i departamentit të marrëdhënieve publike në Ministrinë e Ekonomisë dhe Energjisë
Z.	Eugen Pepa	Këshilltar Ligjor në Parlamentin Shqiptar
Z.	Genc HOXHA	Supervizor i Shërbimit të Rrjetit, Vodafone Albania
Z.	Gentian ISLAMI	Drejtor i Planifikimit Urban, Bashkia Kuçovë
Z.	Gentian MANO	Menaxher i organizatës "Eord Vision", Librazhd
Znj.	Gerta META	Drejtoresh Ekzekutive e Shoqërisë për Kulturë Demokratike (SHKD)
Z.	Hysni AHMETAJ	Specialist në Ministrinë e Integritimit
Z.	Ilir TOPI	Aktivisti i Forumit Rinor të Partisë Demokratike
Znj.	Ingrit PRIZRENI	Shtëpia Botuese "Media Print"
Znj.	Liliana ALIMETA	Shef për kontratat dhe procedurat për donatorët, Ministria e Financave
Znj.	Mimoza KOCIU	Këshilltare për median, zëdhënëse e zyrës së Presidentit të Republikës
Z.	Plarent RUKA	Këshilltar Ligjor, Ministria e Shëndetësisë
Znj.	Plejada GUGASHI	Menaxhere Programi për OLOF Palm International Center Albania
Z.	Redi BADUNI	Kreu i Sekretariatit të Rinisë në Partinë Republikane
Z.	Redi SKENDERAJ	Gazetar, Koha TV
Znj.	Rezarta GODO	Programi "Brain Gain", PNUD
Znj.	Sonila MECO	Gazetare, Klan TV
Z.	Urim BAJRAMI	Kryeredaktor i Gazetës "Shqip"

VITI 2010

Z.	Afrim Kola	Shef i Kontrollit Ajror në Forcat Ajrore Shqiptare
Z.	Alban Fishka	Specialist në Inspektoriatin Teknik Qendror
Znj.	Aleksandra Bogdani	Kryeredaktore në "Top Neës" TV

Znj.	Anila Shqypi	Koordinatorë projekt, GTZ Albania
Z.	Arber Kadia	Drejtor në Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare në Tiranë
Z.	Besjan Pasha	Këshilltar i kryetarit, zëvendës-sekretar i Përgjithshëm i LSI
Z.	Bilbil Keraj	Shef i kabinetit në Bashkinë Kukës
Znj.	Blerta Gjermani	Kryeredaktore, ORA Neës TV
Z.	Dritan Nushi	Zyra e Prokurorit, Rrethi Kavajë
Znj.	Eglantina Bisha	Specialiste pranë Qendrës së biznesit "Eurocol"
Z.	Elton Lula	Menaxher Projekti pranë Shërbimit Ligjor falas në Tiranë
Znj.	Enina Mullaj	Specialiste në departamenti ligjor në Parlamentin Shqiptar
Z.	Enkes Shundi	Këshilltar, Shef i Protokolit të Presidentit të Republikës
Z.	Evarist Beqiri	Specialist ligjor pranë Shërbimit Informativ Shtetëror
Znj.	Fatjona Mejdini	Gazetare, "Shqip"
Z.	Fjorel Como	Specialist në Ministrinë e Transportit/aktivist në Forumin Rinor të PD-së në qytetin e Gjirokastrës
Z.	Genard Kastrati	Drejtor Ekzekutiv në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve
Znj.	Giomela Gjini	Drejtor Teknik në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave
Z.	Ilir Paco	Gazetar "Top Channel"

Znj.	Irena Kita (Dimushi)	Specialiste ligjore në Bankën Credins
Znj.	Jonida Shehu	Gazetare në "Vizion Plus" TV
Znj.	Karolina Risto	Kryeredaktore e Vizion Plus TV
Znj.	Klodiana Thartori	Koordinatorë Programi "Save the Children"
Z.	Klodjan Seferaj	Këshilltar në Këshillin e Ministrave
Znj.	Klotilda Neziri	Shef kabineti në bashkinë e Pogradecit
Z.	Ledio Milkani	Këshilltar Ligjor për Dhomën e Tregëtisë dhe Industrisë
Znj.	Migena Muhaj	Koordinatorë në programin Seiss Partnerships in Health
Znj.	Migena Nelaj	Drejtoresh për median dhe marrëdhënien me publikun pranë KESH
Z.	Ols Lafa	Drejtor në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Znj.	Oriana Arapi	Koordinator për Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integritimit në Këshillin e Ministrave
Z.	Qemal Cejku	Shef kabineti në Bashkinë e Kamzës
Znj.	Rozana Celmeta	Kreu i Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave
Z.	Saimir Shatku	Këshilltar ligjor për administrimin në Këshillin Bashkiak të Tiranës
Znj.	Suela Cela	Specialiste në departamenti ligjor në Ministrinë e Bujqësisë

VITI 2011

Znj.	Ada Ramaj	Ndihmëse e zv.ministrit të Brendshëm
Znj.	Albana Veizi	Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Presidentit të Republikës
Z.	Alvi Bajramaj	Specialist i Marrëdhënieve Publike, QSUT
Znj.	Anxhela Andoni	Aktiviste e Forumit të Gruas të Partinë Socialiste, rrethi Pogradec
Z.	Arlind Lugji	Specialist në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive
Z.	Arnold Hajro	Jurist vendor pranë Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO)
Znj.	Daniela Mehmeti	Juriste pranë Autoritetit Kombëtar të Konkurrencës
Znj.	Enila Hasani	Shefe në Departamentin e Marrëdhënieve me Jashtë në Ministrinë e Brendshme
Z.	Enio Haxhimihali	Shef kabineti në Këshillin Kombëtar të Radio-Televizionit
Znj.	Erjola Muka	Kreu i Sektorit të Politikave të Mjedisit, Bashkia Tiranë
Z.	Genti Çani	Drejtor në Drejtorinë e Mbrojtjes së Pronës Intelektuale, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
Z.	Gentian Xhaxhiu	Gazetar "Shijak TV"
Znj.	Gresa MARTIRI	Juriste pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë
Z.	Helidon BELE	Drejtor në Tirana Bank
Z.	Ilir Stojku	Specialist në Sektorin e Koordinimit, Ministria e Drejtësisë
Znj.	Klesta Hysi	Koordinatorë programi pranë organizatës "Fëmijët Sot"
Z.	Kreshnik Ternova	Administrator, ALK Pharma sh.p.k.
Znj.	Ledi Jahja-Muçaj	Administratore pranë organizatës SNV në Shqipëri
Znj.	Merita Mansaku-Meksi	Oficer Programi, Zyra Austriake për Zhvillim

Znj.	Mirjam Reçi	Drejtoreshë ekzekutive pranë organizatës CSDC Durrës
Znj.	Olta Blaceri	Kryeredaktore e programit "Ora e debatit" në "Ora Neës" TV
Z.	Qamil Dika	Kreu i Këshillit Studentor Kombëtar / Aktivist i PD
Znj.	Rajmonda Lajthia	Gazetare, "Vizion Plus" TV

VITI 2012

Znj.	Albana Shtylla	Shefe kabineti në Zyrën e Avokatit të Popullit/ Anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Znj.	Alisa Demollari	Zëdhënëse/Ministria e Shëndetësisë
Z.	Altin Hoti	Lektor i Ekonomisë Ndërkombëtare në Universitetin Mesdhetar/ Universitetin Evropian
Z.	Altin Ibro	Jurist/ Celibashi Consulting shpk
Z.	Andi Seferi	Drejtes i Komunitetit të Sant'Edigio në Shqipëri
Znj.	Anisa Seferaj	Juriste/ Bashkia Tiranë
Znj.	Ardita Kongjonaj	Specialiste në Agjencinë Kombëtare për Ekzaminimin, Ministria e Arsimit
Z.	Arian Galdini	Kryetar i FDE, Partia për Liri, Demokraci dhe Etikë / Lektor pranë Universitetit Luarasi
Znj.	Baisa Sefa	Kërkuese pranë organizatës Lëvizja Evropiane në Shqipëri
Z.	Elidon Laze	Drejtor në Drejtorinë e Ligjore dhe të Apelit në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Patundshme
Z.	Erlis Shahu	Specialist IT pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve
Z.	Ermal Simaku	Doktor / Anëtar i Forumit Rinor të Partisë Socialiste
Z.	Ermir Godaj	Shërbimi i Përmbarimit, Ministria e Drejtësisë

Znj.	Ervina Domi	Drejtor në Departamentin Ligjor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave
Znj.	Eva Dauti	Juriste, Shoqata Shqiptare e Bashkive
Znj.	Florensa Haxhi	Koordinatorë e strategjive në Këshillin e Ministrave
Z.	Fredi Guga	Drejtor i Qendrës së Shëndetit në Durrës/ Koordinator projekti në "Europartners Development"
Z.	Ilir Kondi	Drejtor i Qendrës së Publikimeve Zyrtare / Aktivist i Partisë Demokratike (PD)
Z.	Ilir Korbi	Jurist në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Patundshme
Z.	Ilir Mimani	Specialist në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore
Znj.	Jorina Gjinar	Menaxher Projekti tek Qendra e Studimeve Future
Z.	Ledio Braho	Jurist në Ministrinë e Integritetit/Asistent profesor në Universitetin e Tiranës
Znj.	Margarita Kola	Specialiste ligjore në Ambasadën Amerikane / Aktiviste e partisë politike Aleanca KuqeZi (AK)
Znj.	Mariola Qesaraku	Koordinatorë projekti pranë Instituti për Demokraci dhe Mësim
Znj.	Marsida Çela	Menaxher Programi tek Qendra e Fëmijëve SOT/ Menaxhere në agjencinë e Shërbimeve sociale GC, NY, SHBA
Znj.	Merita Osmani (Muçaj)	Juriste në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës/Lektore në Universitetin Amerikan të Tiranës
Znj.	Mirela Karapici	Drejtor Marketingu dhe i Marrëdhënieve me Publikun në Postën Shqiptare
Z.	Oltion Kuke	Drejtoreshë Departamenti në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave
Z.	Rezart Xhelo	Specialist pranë misionit të OSBE



Znj. Romina Kuko	Asistent Projekti, OSBE
Znj. Rovena Rojba	Inspektor Vlerësimi në Drejtorinë Rajonale të Taksave, Tiranë
Z. Sokol Bega	Asistent politik, OSBE
Znj. Suela Lala	Aktiviste në Shoqërinë Civile

Znj. Edlira Nasi	Specialiste në kompaninë Antea Cement / Aktiviste e të drejtave civile dhe të minoriteteve
Znj. Elda Gjoka	Themeluese dhe drejtuese e kompanisë Genuine Effect
Znj. Eneida Ahmeti	Avokate tek firma ligjore Shala/Aktiviste në partinë politike Aleanca Kuqezi (AK)

Z. Jugert Jorgo	Nëpunës në Departamentin e Protokollit të Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme
-----------------	---

Z. Julian Llupo	Specialist në Autoritetin e Konkurrencës
-----------------	--

Znj. Klementina Cenkollari	Gazetare, "Ora Neës" TV
----------------------------	-------------------------

Z. Oltion Pengu	Konsulent Lokal në Këshillin e Ministrave
-----------------	---

Znj. Sabina Juka	Eksperte në Këshillin e Ministrave
------------------	------------------------------------

Znj. Sentiljana Barzezi	Specialist tek CEZ/Aktiviste e partisë politike Fryma e Re Demokratike (FRD)
-------------------------	--

Znj. Valbona Lasku	Menaxhere Zyre në BCC Tirana
--------------------	------------------------------

VITI 2013

Znj. Albana Hasanaj	Specialiste në Agjencinë e Zhvillimit të Investimeve në Shqipëri (AIDA)
---------------------	---

Znj. Amela Zaganjori	Arsimtare/Aktiviste në Partinë Demokratike (PD)
----------------------	---

Z. Armand Metani	Menaxher i Përgjithshëm i Milifar sh.p.k.
------------------	---

Z. Arti Cicolli	Drejtor i IT-së në Presidencë
-----------------	-------------------------------

Z. Basir Collaku	Këshilltar dhe Zëdhënës i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave
------------------	---

Znj. Blerina Doracaj	Eksperte ligjore dhe prokurimesh në Agjencinë e Zhvillimit të Zonave Malore / Aktiviste në Partinë Socialiste (PS)
----------------------	--

Znj. Enkeleda Basha	Asistente në Gjykatën e Rrethit Shkodër/Aktiviste e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim
---------------------	---

Z. Erand Nebo	Departamenti i Leasing, Banka Societe General
---------------	---

Znj. Ervis Rahmani	Lektor në Universitetin Kristal/Specialist në Ministrinë e Integritit/Aktiviste në Partinë Socialiste
--------------------	---

Z. Fatmir Konja	Asistent në Zyrën e Presidentit të Republikës
-----------------	---

Znj. Florenca Korbi	Menaxhere Projekti në Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë
---------------------	---

Z. Jonito Bregasi	Kontrollor i Trafikut Ajror/ Aktivist në Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)
-------------------	--

VITI 2014

Znj. Alma Binaj	Asistente pranë zyrës të deputetit Edi Rama në Vlorë
-----------------	--

Znj. Anisa Xhafa	Specialiste e marrëdhënieve publike pranë GIZ Albania/ Aktiviste e partisë FRD
------------------	--



Znj. **Arsela Gjonaj** Specialiste pranë Këshillit Bashkiak Tiranë / Lektore në universitetin e Beratit

Z. **Dritan Cekani** Nëndrejtor i Përgjithshëm i Doganave / Aktivist i Partisë Socialiste

Z. **Elidon Lamani** Menaxher projektesh pranë organizatës "Qendra Rinore e Vlorës" / Aktivist i shoqërisë civile

Z. **Endri Mykaj** Këshilltar ligjor pranë Këshillit të Ministrave

Znj. **Enisa Halili** Specialiste pranë drejtorisë së Planifikimit strategjik të Bashkisë Tiranë

Z. **Erlis Hereni** Këshilltar ligjor pranë ministrit të Brendshëm / Drejtor ekzekutiv i "Aleancës së Rinisë Shqiptare"

Z. **Florjan Mucaj** Nënkretar i Bashkisë Fier/ Aktivist i Partisë Socialiste

Z. **Francesko Mucaj** Sekretar politik i forumit rinor të Partisë Socialiste

Znj. **Ina Metko** Juriste, Ministria e Integritetit Evropian

Z. **Juel Jarani** Zv.rektor në Universitetin e Sporteve

Znj. **Juliana Cici** Zv.komisionere pranë "Avokatit të Popullit"

Z. **Lulzim Omuri** Këshilltar i minibashkisë nr. 2, Tiranë / Aktivist i forumit rinor të Partisë Demokratike

Znj. **Magi Apostoli** Koordinatorë projekti pranë "Europartners Development"

Znj. **Pranvera Myrselaj** Menaxhere financiare pranë "System Group Albania"

Z. **Redi Saliasi** Përgjegjes i PR dhe komunikimit pranë kompanisë "Croën Agents"

Znj. **Rikelda Balliu** Koordinatorë e projektit të Bashkimit Evropian pranë drejtorisë së doganave

Znj. **Vjollca Dako** Drejtore ekzekutive e fondacionit mediatik "Dritan Hoxha"

VITI 2015

Z. **Admir Malaj** Këshilltar pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Znj. **Amela Juka** P.administration / Political activist DP

Znj. **Arlinda Hoti** Drejtore e trajnimeve, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike

Z. **Artur Bardhi** Specialist pranë Dep. Të Integritetit, Ministria e Punëve të Jashtme / Aktivist i LSI

Znj. **Blerina Ago** Këshilltare e Ministrit të Drejtësisë

Znj. **Dorina Puto** Eksperte ligjore pranë Institucionit të Presidentit të Republikës

Z. **Elvin Nuriu** Drejtor i administratës, Instituti i Sigurimeve Shoqërore / Aktivist i PDIU

Znj. **Erjona Rusi** Gazetare, Report TV

Erton Graceni Këshilltar për Teknologjinë pranë Këshillit të Ministrave



Z. Ervis Mocka	Zv.dekan i Universitetit të Vlorës / Këshilltar i PS pranë Këshillit Bashkiak Vlorë	Z. Oljan Kanushi	Koordinator pranë Këshillit të Ministrave	Z. Besfort Lamallari	Kërkues -Autor i raportit vjetor "Freedom House"
Znj. Evis Shurdha	Drejtores e Administratës dhe Shërbimeve, Këshilli i Ministrave	Z. Sofjan Jaupaj	Këshilltar i Ministrisë të Kulturës	Znj. Brikena Hoxha	Asistente ekzekutive pranë bankës "Societe Generale Albania"
Z. Fabian Zhilla	Kërkues mbi krimin e organizuar / Lektor pranë Institutit Kanadez të Teknologjisë	Znj. Tresi Trebicka	Menaxhere programesh mbi zhvillimin e qëndrueshëm pranë "Eco Partners Albania"	Znj. Eda Lika	Asistente ligjore, Zyra e Kryeministrit
Znj. Gentiola Madhi	Kërkuese pranë organizatës Shtetiëeb	Znj. Valbona Mucaj	Trajnuese pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike	Znj. Edlira Osmani	Kërkuese / Koordinatorë pranë misionit EURALIUS
Znj. Irma Kopliku	Anëtare e Parlamentit / Lektore pranë Universitetit të Shkodrës	Znj. Zhanina Dapi	Drejtores e drejtorisë së Integritetit, Ministria e Ekonomisë	Z. Eneo Zguri	Anëtar i Këshillit Kom-bëtar të PD
Znj. Jerina Vataj	Këshilltare e LSI pranë Këshillit Bashkiak Lezhë	VITI 2016		Z. Eraldo Xhani	Këshilltar i grupit parlamentar të PS / Kreu i Dep. Cilësisë, Posta Shqiptare
Znj. Jolanda Mustafaraj	Këshilltare e PS pranë Këshillit Bashkiak Durrës	Znj. Albana Kraja	Shefe e njësisë së përkthimit, Parlamenti Shqiptar	Znj. Freskida Miloti	Producente dhe gazetarë pranë Radio "Tirana"
Znj. Lindita Pali	Këshilltare pranë Këshillit Bashkiak Burrel	Znj. Armela Mitku	Anëtare e Këshillit Drejtues të FRD / Specialiste pranë Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Tiranë	Z. Indrit Puteci	Këshilltar i kryetarit të bashkisë Tiranës
Znj. Marsida Duli	Doktoreshë / Aktiviste e PD	Z. Besard Buzi	Ekspert vendor pranë Këshillit të Evropës	Znj. Juliana Memaj	Kryetare e Bashkisë Ura Vajgurore
Znj. Mirjeta Gjongecaj	Këshilltare e PD pranë Këshillit Bashkiak Bajram Curri			Znj. Julinda Mansaku	Avokate pranë Avokaturës së Shtetit



Znj. Krisilda Fana
Shefe e dep. koordinimit
me institucionet dhe HR,
Presidenti i Republikës

Znj. Manjola Hidri
Eksperte e projekteve
IPA pranë Ministrisë së
Integritimit

Znj. Manushaqe Rina
Lektore në Univer. e
Durrësit / Këshilltare
bashkiake e PD-së,
Dibër

Znj. Mina Skuqi
Juriste / Asistente e
nënkryetarit të Parla-
mentit

Znj. Mirbana Bilali
Drejtoreshë ekzekutive e
kompanisë "Security &
Protection Group"

Znj. Olta Kepucka
Shefe e Burimeve
Njerëzore dhe Finan-
cave, GIZ Shqiperi

Znj. Ornela Liperi
Kryeredaktore e revistës
"Monitor"

Znj. Ramiola Kalemli
Lektore, pranë Univ.
Durrës / Këshilltare
bashkiake e PD-së,
Durrës

Znj. Romira Muka
Lektore në Universitetin
e Shkodrës / Këshilltare
bashkiake e PD-së,
Shkodër

Znj. Senida Mesi
Eksperte kontabël /
Këshilltare bashkiake e
PS-së, Shkodër

Z. Vaeld Zhezha
Këshilltar i ministrit të
Mjedisit

Znj. Zamira Musta-
faraj
Inxhinieri / Këshilltare
bashkiake e PS-së,
Durrës

Znj. Zarie Visha
Drejtoreshë shkolle /
Këshilltare bashkiake e
LSI-së, Kukës

VITI 2017

Znj. Adriana Hatellari
Mjeke / Anëtare e Këshillit
Bashkiak Durrës (LSI)

Z. Arber Kodra
Drejtor Ekzekutiv i Open
Mind Spectrum Albania
(OMSA)

Znj. Aurora Ndreu
Eksperte ligjore pranë
Këshillit të Lartë të Dre-
jtësisë / Lektore pranë
Akademisë Profesionale
të Biznesit

Znj. Bora Muzhaqi
Konsulente e legjislacionit
fiskal, "Ernst & Young
Albania"

Znj. Brisela Kadaja
Drejtoreshë Shkolle /
Anëtare e Këshillit Bash-
kiak Shkodër (PS)

Z. Dritan Palnikaj
Këshilltar, Këshilli i
Ministrave

Z. Enton Duro
Lektor, Universiteti i
Tiranës / Këshilltar pranë
ministrit të Financave

Znj. Enxhi Mero
Eksperte e dep. pro-
grameve ndërkufitare,
Ministria e Integritimit

Z. Erion Cerekja
Kryetar i Dhomës së Treg-
tise Shqipëri -Turqi

Z. Erlis Hoxha
Drejtori i protokollit dhe
arkivës Bashkia Tirane /
Aktivist i PS

Znj. Ersida Teliti
Drejtoreshë e "Qendra e
Konsumatorit" / Lektore,
Universiteti i Tiranës

Z. Gjergj Prabibaj
Drejtor i Uzinës Mekanike,
Bashkia Tiranë / Aktivist
i PS

Z. Isuf Shehu
Themelues i Primis Law,
Tax & Strategic Planing /
Administrator, Advanced
Systems & Technology
shpk

Z. Ivi Bejtja
Sekretar i Forumit Rinor
PD



Znj. Lindita Doda	Mësuese / Anëtare e Këshillit Bashkiak Mat (DP)
Znj. Lindita Shehu	Financiere / Anëtare e Këshillit Bashkiak Dibër (PDIU)
Znj. Lindita Sotiri	Këshilltare e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë
Znj. Lorisa Ylli	Koordinatorë, Qendra Shqiptare e Politikave / Aktiviste PD Durrës
Znj. Minushe Lazaj	Sekretare e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Kuvendi Shqipërisë
Znj. Mona Xhexhaj	Kërkuese / Koordinatorë projekti pranë EMA
Z. Renato Demiraj	Specialist IT, Shkolla e Administratës Publike / Aktivist i PS
Z. Soljan Celibashi	Partner menaxhues, CC Law Office
Znj. Ujvara Ponari	Këshilltare diplomatike, Institucioni i Presidentit të Republikës
Znj. Zana Elezi	Mjeke / Kryetare e Këshillit Bashkiak Klos (PD)

VITI 2018

Z. Besart Mataj	Drejtor i komunikimit pranë Shërbimit Shtetëror të Punësimit / Aktivist i PS
Z. Bledar Qalliu	Këshilltar pranë Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Evropës
Znj. Briselda Zhuzhi	Asistente ekzekutive pranë Institucionit të Presidentit të Republikës
Z. Donjet Gjoka	Ekspert në departamentin e Strategjive dhe Politikave, Ministria e Brendshme
Znj. Erinda Toska	Menaxhere programi, Programi i Zhvillimit të Rajoneve
Znj. Geldona Metaj	Menaxhere projektsh në Pjesëmarrjen e Gruas në Vendimmarrje / Lektore pranë Univ. Tiranës
Znj. Jetmira Sula	Eksperte e B.NJ. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve
Znj. Jonada Mamo	Anëtare e Këshillit Bashkiak Durrës (PDIU)/Lektore në Univ. e Durrësit

Z. Klevis Pojana	Nënkryetar i Lëvizjes Rinore për Integrim (LSI)
Znj. Ledia Lila	Specialiste pranë Bashkisë Tiranë/Aktiviste e Forumit Rinor të Partisë Demokratike (PD)
Znj. Megi Melani	Eksperte e Integritimit Evropian pranë Ministrisë së Financave
Z. Rezar Balla	Gazetar/Ekspert i PR pranë "Lëviz Albania"
Znj. Rosela Gjylbegu	Drejtoreshë e Protokollit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Kuvendi i Shqipërisë
Z. Sidrit Tako	Këshilltar pranë Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë
Znj. Stela Kruja	Eksperte e projekteve të zhvillimit rajonal, Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Znj. Valbona Gogu	Drejtoreshë e Projekteve të Asistencës së Huaj, Ministria e Mjedisit
Znj. Valmira Guzi	Menaxhere projektsh / Lektore pranë Univ. Elbasanit

* Pozicioni i referohet profil të mbajtur në periudhën e pjesëmarrjes në program

ASP AKADEMIA E STUDIMEVE POLITIKE PUBLIKIME



Garantimi i transparencës në zbatimin e reformës së Administratës Publike

Punimi fokusohet në analizën e ecurisë dhe progresit të reformës në Administratën Publike, dhe kontributin që kjo reformë ka dhënë në përmirësimin e zbatimit të parimeve të mirëqeverisjes, veçanërisht atë të transparencës.



Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjnor në qeverisjen vendore - Rasti Shkodër

Ky punim vlerëson integrimin e perspektivës gjnore në buxhetim në Bashkinë Shkodër, me qëllim ndërgjegjësimin e këshillit bashkiak dhe administratës bashkiake, si dhe të paraqesë instrumente në vlerësimin e kuadrit fiskal për një zhvillim social gjithëpërfshirës.



Një diplomaci ekonomike efektive: Rasti i Shqipërisë

Dokumenti synon të analizojë rolin e diplomacisë ekonomike shqiptare, duke u mbështetur në parimin e mirëqeverisjes efikasiteti dhe efektshmëria, për zhvillimin dhe thellimin e marrëdhënieve ekonomike e tregtare të Shqipërisë, me vende të ndryshme.




Përfshirja sociale në kuadër të politikave vendore - Rasti Elbasan

Punimi sjell një analizë të masave strategjike dhe sektoriale të ndërmara nga pushteti vendor, duke u fokusuar në rastin e bashkisë Elbasan, për përfshirjen sociale të qytetarëve dhe rezultatet që kanë sjellë në grupet vulnerable të shoqërisë këto politika.



Monitorimi i situatës së legjislacionit të Eficiencës së Energjisë - 2018

Raporti monitories i zbatimit të legjislacionit të eficiencës së energjisë në Shqipëri përgjatë vitit 2018, veçanërisht të ligjit të Eficiencës së Energjisë dhe ligjit për Performancën e Energjisë së Ndërtesave, identifikon sfidat dhe mundësinë për arritjen e këtyre objektivave.



Udhëzuesi i votuesit për herë të parë - 2019

Ky udhëzues është përgatitur nga ASP në kuadër të programit "Ndërgjegjësimi i votuesve për herë të parë - 2019". Botimi u drejtohet të rinjve me qëllim informimin e mbi rëndësinë e pjesëmarrjes, procesin e votimit si dhe penalizimet penale në rast të abuzimit me këtë të drejtë që kanë fituar.

Akademia e Studimeve Politike

Kotoni Center,
Rr.Donika Kastrioti, Nr.3,
Kati 4, Zyra 2
Tirane, Shqipëri

Tel/fax: +355 4 2272173
+355 4 4504788
E-mail: info@asp.al
Web: www.asp.al

Në rubrikën "Publikime" të faqes sonë
www.asp.al mund të shkarkoni të gjitha
botimet në versionin pdf.
Shkoni këtë kod për më tej QR CODE



- Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike
- Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike
- Akademia Studimeve Politike
- Akademia e Studimeve Politike

Programi i Shkollës së Studimeve Politike
financohet nga Këshilli i Evropës dhe
Ambasada e Zvicrës në Shqipëri si edhe
vetë kontributet e pjesëmarrësve



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Ambasada e Zvicrës në Shqipëri